



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME
AGJENCIA E ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA
NJËSIA ANKANDIT

NJOFTIMI I ANKANDIT

1. Autoriteti shites: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara
Adresa : Rruga Kavajës, Kompleksi “Delijorgji”, Kulla C1, K.1, H.2, Tiranë.
Nr.Tel +35542254071

2. Data e zhvillimit te ankandit 09.03.2026 ora 10:00.

3. Lloji i Procedurës standarde te ankandit Procedurë e Hapur.

4. Objekti i Shitjes: “2280 litra Benzinë pa plumb” .

5. Përshkrim i shkurtër i objektit te shitjes:

Objekti i shitjes është pasuri e sekuestruar në cilësinë e provës materiale dhe ndodhet e depozituar në 38 (tridhjetë e tetë) bidonë plastik me ngjyrë kafe në të kuq, me mbishkrime 60 LT, të mbushur plotësisht. Bidonat janë të magazinuara në ambjentet e magazins së AAPSK.(Specifikimet e mallit objekt ankandi janë nxjerrë nga testimet e nxjerra nga ISHTI dhe raport testimi i bashkangjitet dokumentave standarte të ankandit.

6. Vlera fillestare: 103 194.85(njëqind e tre mijë e njëqind e nëntëdhjetë e katër pikë tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh.

Çdo person i interesuar për blerjen e mallrave objekt ankandi duhet të paraqesë;

- a. Deklarim personal te secilit pjesëmarrës, qe vërteton së ky i fundit nuk eshte ne konflikt interesi, sipas dispozitave te ligjit Nr. 10192, date 03.12.2009, te ndryshuar dhe te ligjit Nr.34/2019, te ndryshuar.
- b. Mandat pagesën apo garancinë bankare që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 10% të vleftës së ankandit. Pagesa prej 10% e vleftës së ankandit, për pjesmarrje në ankand është **10 319.485 (dhjetë mijë e treqind e nëntëmbëdhjetë pikë katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë**, e cila do të kryhet në llogarinë bankare të AAPSK-së.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brënda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare mund të bëhen

pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të keni tërhequr pranë kësaj agjencie autorizimin për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga perfaqësuesi i institucionit.

Shënim: Sqarime me të hollshme mbi kriteret e vendosura do të jepen në “Dokumentat standarte të ankandit”.

7. Vendi i zhvillimit të ankandit: Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Adresa : Rruga Kavajës, Kompleksi “Delijorgji”, Kulla C1, K.1, H.2, Tiranë.

Nr.Tel +35542254071

8. Afati i fundit kohor për dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje: Datë 09.03.2026 ora 10:00.

9. Informacion mbi dokumentet e ankandit:

Dokumentet e ankandit mund të trerhiqen prane autoritetit shites

Dokumente me pagesë:

Po X Jo ☐

Nëse Po

Monedha **Lekë** Çmimi **1000**

Dokumentet standarde të ankandit përbehen nga:

- Formulari i njoftimit;
- Kërkesa për pjesëmarrje;
- Formulari i ofertës;
- Ftesa për oferte;
- Formulari i njoftimit të fituesit;
- Formulari i publikimit të njoftimit të fituesit;
- Procesverbali/et i/e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

10. Kërkesa për pjesëmarrje, dokumentet dhe informacionet e kërkuara dorëzohen nga kandidatet blerës ne kopje fizike, me poste ose dorazi, ne vendin e përcaktuar ne dokumentet e ankandit.